

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO PROKURORI I SHTETIT - DRŽAVNI TUŽILAC Sekretariat - Zyrë e Kryeprokurorit të Shtetit Sekretariat - Kuvendit të Kryeprokurorit të Shtetit ARKIVA - ARHIVA		
Pranuor 03 -01- 2013 Prinjeno		
Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Čas prijema	Nivisurimi i pranuesit Pobis primaoca
03/2013		



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Drzavnog Tuzioca / Office of the Chief State Prosecutor

A. nr. ~~241/12~~ 01-2013

Datë 03.12.2012

P R I S H T I N Ë

KRYEPROKUROREVE TE PROKURORIVE THEMELORE

Ferizaj, Gjakove, Gjilan, Mitrovice, Peje, Prishtine dhe Prizren

KRYEPROKURORIT DHE ZEVENDESKRYEPROKURORIT TE PROKURORISE SPECIALE TE REPUBLIKES SE KOSOVES

Prishtine.

Kodi i Ri i Procedures Penale te Kosoves, ne dispozitat e nenit 150 rregullon proceduren e këqyrjes se vendit te ngjarjes.

Kqyrja e vendit te ngjarjes nga ana e prokurorit dhe policise kryhet per tu njoftuar personalisht me gjendjen, e cila do t'u ndihmonte ne përcaktimin e besueshmerise ose gjetjen e fakteve, por ne rastin e tille, rezultatet per gjykatën jane te papranueshme.

Tani kqyrja e vendit te ngjarjes ndahet ne dy lloje. Ne këqyrjen e vendit te ngjarjes kur identiteti i te dyshuarit, te pandehurit apo mbrojtësit eshte i njohur per prokurorin e shtetit dhe kur identiteti i tyre nuk eshte i njohur.

Me qellim te zbatimit te drejte te ligjit leshoj kete:

U D H E Z I M

Kur identiteti i te dyshuarit, te pandehurit apo mbrojtësit te tyre eshte i njohur per prokurorin e shtetit, prokurori i shtetit do ti njoftoje ata per këqyrjen e vendit te ngjarjes.

Nese prania e te dyshuarit ne vendin e ngjarjes paraqet rrezik per sigurine prokurori i shtetit do ti caktojë atij, nese ai nuk ka mbrojtës te autorizuar, nje mbrojtës sipas detyres zyrtare dhe mbrojtësin e tille do ta njoftoje per kohen e këqyrjes se vendit te ngjarjes.

Kur identiteti i te dyshuarit, te pandehurit apo mbrojtësit nuk eshte i njoftur per prokurorin e shtetit ai do ta ftojë gjyqtarin e procedures paraprake per te marre pjese dhe vëzhguar këqyrjen e vendit te ngjarjes.

Per cdo këqyrje te vendit te ngjarjes prokurori i shtetit harton procesverbal dhe kur ne këqyrjen e vendit te ngjarjes merr pjese edhe gjyqtari i procedures paraprake do ta shenoje kete te dhene ndersa poashtu do te shenoje ne procesverbal se a e ka njoftur per këqyrjen e vendit te ngjarjes te dyshuarin, te pandehurin apo mbrojtësin e tyre.

KRYEPROKUROR I SHTETIT

Ismet Kabashi

